

## AKTI I THEMELIMIT

TE SHOQERISE PRIVATE "EKOBEON" SH.P.K. PER PRODHIM  
TE MATERIALEVE TE NDEBTIMIT, TREGETIM DHE EKSPORT-IMPORT

Sot me date 2/10/1995, ne te quajturit:

- Pellumb Kociasi, i biri Qerimit dhe Ervehese, lindur me 1952 ne Korce dhe banues ne Elbasan, Lagja #L.Gura-kuqi#, Bul.#Qemal Stafa#, Pall.57, H.A Nr.13
- Sulejman Rumasi, i biri i Bilbilit dhe Feruzes, lindur me 1952 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, Lagja e Re, Rr.# 28 Nentori # Nr.10.
- Fatmir Lamce, i biri Osmanit dhe Nadirese, lindur me 1937 ne Starove (Pogradec) dhe banues ne Elbasan, Lagja #Kong.Elbasanit#, Pallati 36/5
- Gezim Jazxhiu, i biri Sadikut dhe Behijes, lindur me 1942 ne Korce dhe banues ne Elbasan, Lagja #Aqif Pasha# Rruga #28 Nentori# Pallati 31.
- Raimond Hasballa, i biri Kadriut dhe Ifetes, lindur me 1955 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, Lagja #Kongr.Elbasanit#, Rruga # 28 Nentori #, Pallati 72, H.B Nr.4.

bashkuam kapitalet dhe themeluan shoqerine me pergjegjasi te kufizuar si partnere ortake te saj.

### NENI 1

Shoqeria emertohet: " Ndermarrja e prodhimit te materialeve te ndertimit, tregetit dhe eksport-import, "EKOBEON" Sh.P.K.

### NENI 2

Selia e shoqerise ndodhet ne qytetin e Elbasanit, ne krahun e djathte te rruges Elbasan-Cerrik dhe te ures se kanalit # Naum Panxhi #, prane fshatit Bujqes ( ish poligoni i ushtrise ).

### NENI 3

Shoqeria ka nje aktivitet mbi dhjete vjet.

### NENI 4

#### OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria do te jete e pavarur dhe do te veproje pa kufi, me aktivitet si me poshte:

#### A.- AKTIVITETI I PRODHIMIT TE MATERIALEVE TE NDEBTIMIT

1.- Ndertim poligoni, per prodhimin e materialeve te ndertimit, si betone, llace, prodhime elementesh ndertimore prej betoni dhe beton- arme, parafabrikate si dhe trajtimi i tyre.

- 2.- Prodhime konstruksionesh dhe artikujsh te ndryshem druri dhe metali, qe i sherbejne ndertimit, etj.
- 3.- Prodhime te ndryshme prej guri dhe mermeri.

**B - AKTIVITETIT TREGETAR**

- 1.- Eksport-import dhe tregetim, me shumice e pakice, te materialeve te ndertimit dhe te mallrave qe prodhohen nga vete shoqeria.
- 2.- Eksport-import dhe tregetim, me shumice e pakice te mallrave te tjera te ndryshme.

**NENTI 5**

Kapitali fillestar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) lek, i ndare ne 100 (njqind) pjese me nga 1.000 (njemije) lek sejcila. Ne kete kapital perfshihet siperfaqja e tokes prej 9864 M2 e poligonit, objektet e ndertuara, makinerite dhe paisjet ekzistuese dhe vlera e investimeve per rinovimin dhe venien ne shfrytezim te tyre. Ne kapitalin fillestar ortaket marrin pjese si me poshte:

Pellumb	Kociasi	mban	50,0	pjese,
Sulejman	Rumasi	mban	12,5	pjese,
Fatmir	Lamce	mban	12,5	pjese,
Gezim	Jazxhiu	mban	12,5	pjese,
Raimond	Hazballa	mban	12,5	pjese.

Rezultati financiar i shoqerise, fitimi ose humbja, do te ndahet simbas pjeseve qe mban sejcili partner ne kapitalin themelor.

**PARTNERET ORTAKE PER THEMELIMIN SHOQERISE \*EKOBETON\* SH.P.K.**

PELLUMB KOCIASI

SULEJMAN RUMASI

FATMIR LAMCE

GEZIM JAZXHIU

RAIMOND HASBALLA

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 MINISTERIA E DREJTESIE  
 NOTERIA  
 Nr. 5/101

Elbasan ,me 10/11/1995

**V E R T E T I M**

Sot me date 10/11/1995, ne zyren e noterise, perpara meje, notes Majlinda Lato, u paraqiten personalisht, shtetasit Sulejman Rumasi, i biri i Bilbilit, i datlindjes 1952, banues ne Elbasan, Fatmir Lamce, i biri i Osmanit, i datlindjes 1937, banues ne Elbasan, Gezim Jazxhiu i biri i Sadikut, i datelindjes 1943, banues ne Elbasan, Raimond Hasballa, i biri i Kadriut, i datlindjes 1955, banues ne Elbasan, Pellumb Kociasi, i datelindjes 1952, banues ne Elbasan, te peste me kombesi Shqiptare, te cilet mu bene te njohur nepermjet leternjoftimit qe me paraqiten, te afte per te kryer veprime juridike, te cilet deklarojne se, aktin e themelimit te mesiper, e kahe hartuar me vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjet ne fuqi. Neneshkrimi i tyre, u vertetua nga une noterja.



NOTERJA  
 MAJLINDA LATO/



## S T A T U T

### I SHOQERISE PRIVATE \* EKOBETON \* SH.P.K. PER, PRODHIMIN E MATERIALEVE TE NDERTIMIT, TREGTIM E EKSPORT-IMPORT.

#### F O R M I M I

##### NENI 1

Shoqeria private me pergjegjesi te kufizuar, per prodhimin, e materialeve te ndertimit, tregtim dhe eksport-import, \*EKOBETON\* SH.P.K. eshte themeluar, nga partneret ortake te saj, zoterinjve:

- PELLUMB KOCTASI, i biri Qerimit dhe Ervehese, lindur me 1952 ne Korce dhe banues ne Elbasan, Lagja \*L.Gurakuqi\* Bul.\*Qemal Stafa\* Pall.57 H.A Nr.13
- SULEJMAN RUMASI, i biri Bilbilit dhe Feruzes, lindur me 1952 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, Lagja \* e Re \* Rruga \* 28 Nentori \* Nr. 10.
- FATMIR LAMCE, i biri Osmanit dhe Nadirese, lindur me 1937 ne Starove ( Pogradec ), banues ne Elbasan, Lagja \*Kongresi Elbasanit\*, Pallati Nr. 36/5.
- GEZIM JAZXHIU, i biri Sadikut dhe Behijes, lindur me 1942 ne Korce dhe banues ne Elbasan, Lagja \*Aqif Pasha\* Rruga \*28 Nentori\*, Pallati Nr.31.
- RAIMOND HAZBALLA, i biri i Kadriut dhe Ifetes, lindur me 1955 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, Lagja \* Kongresi Elbasanit \*, Rruga \* 28 Nentori \*, Pallati 72, Hyrja B, Nr.4.

#### SELIA E SHOQERISE

##### NENI 2

Shoqeria, e ka qendren e vet ne Republiken e Shqiperise, ne qytetin e Elbasanit, ne krahun e djathte te rruges Elbasan-Cerrik dhe te ures se kanalit \* Naum Panxhi \*, prane fshatit Bujqes (ish poligoni i ushtrise) dhe mund te krijojte filiale te tjera, vendqendrim te dyta, operative, perfaqsi dhe agjensi ne te gjithe territorin e vendit dhe jashte tij.

#### KOHE ZGJATJA

##### NENI 3

Koha e zgjatjes se veprimtarise ekonomike e shoqerise eshte mbi 10 (dhjete) vjet.

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE

##### NENI 4

Objekti i kesaj shoqerije eshte:



A.-Aktiviteti i prodhimit te materialeve te ndertimit

- 1.-Ndertim dhe shfrytëzim poligoni per prodhimin e materialeve te ndertimit, si betone, llace, prodhime elementesh ndertimore prej betoni dhe beton-arme, parafabrikate si dhe trajtimi i tyre.
- 2.-Prodhime konstruksionesh dhe artikujsh te ndryshem druri dhe metali, per ndertimet, etj..
- 3.-Prodhime te ndryshme prej guri dhe mermeri.

B.-Aktiviteti tregëtar.

- 1.-Eksport-import e tregëtim te mallrave me shumice dhe pakice qe prodhohen nga shoqëria dhe ndermarrjet e tjera te fushes se ndertimit.
- 2.-Eksport-import e tregëtim te mallrave me shumice e pakice te fushave te tjera.

NENI 5

Shoqëria mund te ndryshoje emrin, seline si dhe objektin e vepritarise se saj, sipas vendimeve qe do te marrin pronaret e saj.

KAPITALI I SHOQËRISE

NENI 6

Kapitali i shoqërise eshte 100.000 (njqindmije) lek, i ndare ne 100 (njqind) pjese me nga 1.000 (njemije) lek sejcila. Ky kapital perbehet nga siperfaqja e tokes se poligonit prej 9864 m2, objektet ekzistuese, paisjet dhe makinerite ekzistuese dhe vlera e investimit per rinovimin dhe vendien ne funksionim te tyre. Ky kapital ne masen e plote eshte formuar nga te gjashte ortakët, ne vlefte monetare dhe ne natyre dhe eshte i shlyer plotesisht. Ne kete kapital, ortakët mbajne:

Pellumb	Kociasi	mban 50,0	pjese,
Sulejman	Rumasi	mban 12,5	pjese.
Fatmir	Lance	mban 12,5	pjese.
Gezim	Jazxhiu	mban 12,5	pjese.
Raimond	Hazballa	mban 12,5	pjese.

NENI 7

Transferimi i pjeseve te kapitalit duhet te realizohet sipas normave te parashikuara nga nenet numur 45, 46, 47 dhe 49 te Ligjit \*Per shoqërite tregëtare\* Nr. 7638 date 19/11/1992.

Kapitali i shoqërise mund te shtohet ose te pakesohet me miratimin e Asamblese se Partnereve, gjithnje duke u mbeshtetur ne ligjin e mesiperm.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

NENI 8

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi. Shoqëria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj si person juridik ne Gjykatën e Tiranës dhe ndersa ushtron aktivitetin e saj me rregjistrimin ne librin e Ministrise se ndertimit dhe te turizmit dhe ne dengen e tatim-taksave.



NENI 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen: " Shoqeria e prodhimit te materialeve te ndertimit, tregtare dhe eksport-import \*EKOBETON\* SH.P.K.

NENI 10

Shoqeria, vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashtekontraktore brenda kapitalit te saj. Te gjashte ortakët mbartin rrezikun e veprimtarise se shoqerise, ne nivelin e shumës se mjeteve te investuara ne shoqeri.

NENI 11

Shoqeria eshte prone e pese themeluesve te saj. Ajo ka strukturen e saj organizative si me poshte:

Institucionet drejtuese te shoqerise jane:

1. ASAMBLEA E PARTNEREVE
2. KESHILLI I ADMINISTRIMIT TE SHOQERISE
3. ADMINISTRATORI I PERGJITHSHEM
4. EKSPERTET KONTABEL

Menyra se si keto institucione do te themelohen dhe numuri i aneta-reve, ne mbeshitet me ligjet ne fuqi dhe kerkesat e ketij statuti, do te percaktohen ne rregulloren brendeshme te shoqerise.

Asamblea e Partnereve, nepermjet numurit te votave te secilit part-ner, ne perputhje me raportet e pjesmarrjes, ne kapitalin baze te sho-gerise, miraton:

- \*\* Statutin dhe rregulloren e brendeshme te shoqerise
- \*\* Drejtimet kryesore te zhvillimit te aktivitetit te shoqeri-se, planifikimin ekonomik dhe bilancin financiar.
- \*\* Zvogelimin ose zmadhimin e kapitalit baze te shoqerise.
- \*\* Menyren, sasine e shperndarjes se fitimit vjetor te shoqeri-se, madhesine e fondit rezerve, dhe fondeve te tjera specia-le.
- \*\* Zgjedhjen e kryetarit te saj, te Keshillit te Administrimit dhe Administratorin e Pergjithshem.
- \*\* Kufizimin e kompetencave te administratoreve dhe te opera-cioneve qe i kalojne kufijte e lartpermendur.
- \*\* Mbylljen e aktivitetit te nje dege, apo te gjithe shoqerise dhe vendosien e likuidatoreve.
- \*\* Miralimin e llogarive rrjedhese dhe marrjen e kredive me afat te shkurter dhe te gjate.
- \*\* Fmerimin e eksperteve kontabel.

Asamblea e Partnereve mblidhet nje here ne 6 (gjashte) muaj dhe drejtohet nga kryetari i saj, qe eshte njeri prej ortakeve dhe qe ndry-shohet cdo dy vjet. Vendimet e Asamblese se Partnereve aprovohen me mo-dalitet te percaktuar nga kryetari i saj dhe ato jane te detyrueshme per te gjithë ortakët edhe neqoftese nuk jane prezent ose nuk jane dakort, por ne asnje rast shumica nuk mund ta detyroje njerin ortak te shtoje pjesen e tij te kapitalit. Asamblea e Partnereve mund te mblidhet edhe jashte radhe per probleme te rëndësishme dhe me kerkesë te njerit prej administratoreve. Per veprime te tjera aktiviteti i Asamblese se Partne-reve mbeshitet ne ligjin Nr.7638 date 19/11/1992 \*Per shoqerite tregta-re\*.

 Asamblea e Partnereve ka perfaqsim ligjor te shoqerise perballe te treteve ne gjykim, dhe te drejten te ndermarre masat e nevojshme sipas rastit dhe kerkesave gjyqsore dhe administrative, per odo shkalle gjykimi revokimi e kasacioni dhe te emeruje per kete avokatet e nevojshem.

## NENI 12

Keshilli i Administrimit te shoqerise, ndjek gjithë aktivitetin ekonomik, tekniko-financiar, si dhe zbatimin me korrektesi te statutit dhe rregullores se brendeshme te shoqerise. Vepron ne mbeshtetje te Ligjit Nr.7638 date 19/11/1992 \*Per shoqerite tregtare\*. Vendimet e tij kane fuqi vetem per periudhen qe ai drejton. Funkcionet e keshillit te administrimit jane si me poshte:

- \*\* - Te ndjeko zbatimin e drejtimeve kryesore te aktivitetit te shoqerise.
- \*\* - Te hartoje dhe miratoje plane financiare ne zbatim te drejtimeve te mesiperme.
- \*\* - Te ndryshoje prodhimin qe do te realizohet dhe punen perkalesc qe duhet kryer, brenda objektiveve te aktivitetit te shoqerise.
- \*\* - Ti propozoje Asambles se Partnereve, ndryshimet e nevojshme ne kapitalin e shoqerise.
- \*\* - Te zbatoje procedurat e nevojshme per shlyerjen e llogarive qe i takojne ortakut qe largohet nga shoqeria.

Unanimiteti i Keshillit Administrimit, eshte i nevojshem per:

- a. - Hapjen e letrave te kreditit ne lek ose valute.
- b. - Ne percaktimin e numurit te punonjesve dhe pagave te tyre.

Per probleme te tjera Keshilli Administrimit vendos me shumice votash dhe per ndonje rast kur nuk bihet dakort, problemi shtrohet ne Asamblene e Partnereve per marrje vendimi.

Administratori i pergjithshem, vepron konform ligjit te Kuvendit Popullor # Per Shoqerite tregtare # Nr.7638 date 19/11/1992, kerkesave te ketij statuti dhe rregullores se brendeshme te shoqerise dhe ka keto te drejta e detyra:

- \*\* - Drejton veprimtarine e Keshillit te Administrimit.
- \*\* - Firmos te gjitha aktet dhe vendimet e Keshillit Administrimit te shoqerise.
- \*\* - Hyn ne veprime me bankat mbi bazen e mandatit te dhene.
- \*\* - Pergatit raportet dhe informacionet financiare per Asamblene e Partnereve.
- \*\* - Mban pergjegjisi te plote ligjore per periudhen qe ai drejton aktivitetin e shoqerise.
- \*\* - Hyn ne mardhenije me te trete dhe lidh kontrata me to.

Administratori i pergjithshem i shoqerise, zgjidhet nga Asamblea e Partnereve, odo dy vjet me te drejte rizegjedhje edhe nje here. Ai mund te zgjidhet edhe pas disa vitesh.

Keshilli i Administrimit mund ti delegoje nje anetari te tij, detyrat e nje administratori te zakonshem per nje sektor specifik (Keshilltar i deleguar) ose per gjithë aktivitetin, (Administrator i deleguar). Kufijte e shpenzimeve dhe kompetencave do te vendosen nga Keshilli i Administrimit ne aktin e emerimit.

Ekspertet kontabel, veprojne sipas ligjit \*Per shoqerite tregtare\* Nr. 7638 date 19/11/1992, ligjeve te tjera ne fuqi, statutit dhe rregullores se brendeshme te shoqerise.

Ortakët e shoqërisë dhe administratori i ngarkuar prej tyre, janë të veshur me të gjitha fuqitë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë, pa asnjë lloj kufizimi. Ata kanë mundësi të kryejnë të gjitha aktet që konsiderojnë të nevojshme për arritjet e shoqërisë. Ata kanë të drejtë midis të tjerash të blejnë e të mbajnë pasuri, të lidhen me shoqëri të tjera të vendit ose të huaja, të kryejnë çdo lloj veprimi pranë të gjitha zyrave private apo shtetërore që kanë të bëjnë me garancitë, ipotekat. Të kryejnë pranë institucioneve bankare dhe financiare, veprime depozitimi, kreditimi, pagesa, arketime. Në këto raste administratori i ngarkuar është i detyruar të japë llogari në Asamblenë e Partnerëve.

Partnerët ortakë kanë të drejtat e mëposhteme:

1.- Të marrë pjesë vote në drejtimin dhe administrimin e aktivitetit të shoqërisë në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin e saj. Çdo partner ka të drejtë të votojë për vendimin që do të merret në propozicion me numurin e votave që ka në raport me kapitalin kryesor.

2.- Të marrë fitimin në çdo formë ose shumë nga aktiviteti i shoqërisë në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin e saj.

3.- Të marrë pjesë vote, ose nepërmjet përfaqësuesve të vet, të paisur me prokurë, në çdo institucion të shoqërisë.

4.- Të jenë të informuar plotësisht për të gjitha të dhenat që kanë lidhje me situatat dhe aktivitetin ekonomik, financiar dhe tregëtar të shoqërisë. Të jenë të informuar për të gjithë dokumentacionin si p. sh. raportin e administrimit, bilanci ekonomik vjetor, planifikimi vjetor dhe perspektiv etj.

5.- Të kërkojë mbledhjen e Asamblese së Partnerëve për probleme të rëndësishme, të bëjë propozime dhe të diskutojë në to.

6.- Të tërhiqet nga shoqëria duke i transferuar pjesët e tij të kapitalit kryesor tek partnerët e tjerë të shoqërisë, të ndara në raport me përqindjen në kapitalin fillestar, ose me miratim të Asamblese së Partnerëve tek një pale e trete. Duke u tërhequr partneri nuk është i lirë nga detyrimet e mëparëshme kundrejt shoqërisë dhe anasjelltas. Partneri që largohet nuk ka të drejtën e marrjes së mjeteve kryesore të shoqërisë, por vetëm vlerën e tyre sipas përqindjes që ka në kapitalin fillestar.

7.- Në rast aksidentimi, vdekje ose dalje në pension të një ortakut, ai ka të drejtë të zëvendësohet nga një pjesëtar i afërm i familjes (Gruaja ose femijet). Për persona të tjerë, mbi bazën e prokures, lëshuar nga partneri, kjo bëhet me miratim të Asamblese së Partnerëve, ose mund të zbatohet pika 6 e këtij neni.

Partnerët ortakë janë të detyruar:

1.- Të depozitojnë sasinë e tyre të kapitalit në vlefte monetare në dispozicion të shoqërisë për kapitalin fillestar të saj.

2.- Të japë shoqërisë të gjithë informacionin e kërkuar për të arritur objektivat në aktivitetin e saj.

3.- Të kryejnë me ndershmeri detyrën në funksionet që ka në drejtimin e shoqërisë. Nëqoftesë vertetohen veprime që demtojnë rendë shoqërore ose vjedhje të vlerave të saj, partneri në fjale detyrohet me vendim të Asamblese së Partnerëve të tërhiqet nga shoqëria dhe për pjesën e tij të kapitalit, zbatohet pika 6 e Nenit 14, pasi zbritet nga shpërblimi vlera e demit të shkaktuar.

4.- Kjo masë zbatohet edhe për rastet kur partneri largohet nga detyra e ngarkuar nga shoqëria për një kohë të gjatë, jashtë afateve të miratuara nga Asambleja e Partnerëve.

5.-Partneret jane te detyruar te ruajne sekretin e shoqerise, te dokumentacionit dhe teknologjise, te eksperiences dhe personelit te degeve dhe lidhjeve te saj. Ato jane pergjegjes per pasojat qe mund te shkaktohen nga shkelja e ketij rregullave te ketij neni.

#### NENI 14

Perfaqsimi i shoqerise i perket administratorit te ngarkuar. Ai ka te drejten e perfaqsimi te shoqerise ne organe gjyqsore dhe administrative, te caktoje dhe te pushoje avokate per cdo problem.

#### BILANCI DHE TE ARDHURAT

#### NENI 15

Veprimet ekonomike dhe finaciare te shoqerise mbyllen me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne fund te cdo periudhe ushtrimore, Keshilli i Administrimit per gatit bilancin dhe dokumentat relative brenda 31 Marsit te cdo viti, ne menyre te tille, qe te lejoje aprovimin e tyre nga ana e Asamblese Partnereve, brenda dates 30 Prill per te lejuar shlyerjen e detyrimeve te parashikuara nga ligji Nr. 7661 date 19/01/1993 \* Per kontabilitetin\*.

Shoqeria krijon fondin e saj rezerve dhe fonde te tjera speciale financiare, per zhvillimin e metejshem, stimujt ekonomike, per raste inflacioni, ose mungese fronti pune. Madhësia e ketyre fondeve, menyra e perdorimit dhe koha jane objekt i miratimit te Asamblese se Partnereve.

#### NENI 16

Fitimi i realizuar nga degët e shoqerise, pas pageses se detyrimeve ligjore taksative, sigurimit te fondit rezerve, sigurimit te mbi 5% te rezerves ligjore dhe fondeve te tjera speciale, u ndahet partnereve ortake, pjesmarres te sejciles degë te shoqerise ne menyre proporcionale me kapitalin kryesor, te percaktuar ne statut dhe ne kontraten e themelimit te shoqerise. Ky fitim ndahet nje here ne vit dhe jo me vone se dy muaj, mbas mbylljes se bilanceve financiare te aktiviteteve te shoqerise. Reklamimi i dividendeve behet ne baze te nenit 70 te ligjit Nr.7638 date 19/11/1992, \* Per shoqerite tregtare\*.

#### SHPERNDARIA E SHOQERISE

#### NENI 17

Shperndarja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfarido shkak, si humbja e kapitalit, pamundesi veprimtarie, etj. Shperndarja behet duke e mbeshtetur ne ligjin # Per shoqerite tregtare # Nr.7638 date 19/11/1992. Me vendim te Asamblese se Partnereve percaktohet shperndarja e shoqerise dhe per kete qellim caktohet nje likuidator, qe vepron sipas ligjit te mesiperme dhe ben vleresimin e pasurive. Pjesa e mbetur nga ky vleresim, kapitali kryesor, shitja e mjeteve kryesore, pasi te jene paguar te gjitha detyrimet, ndahet ne propocion me kontributin e sejcilit, ne ish kapitalin fillestar te shoqerise.

#### DISPOZITA TE PEGJITHESHME

#### NENI 18

Ne rast te ndryshimit te ligjit, Keshilli i Administrimit, do te procedoje menjehere per thirrjen e Asamblese se Partnereve, per te bere pershtatjet e nevojshme konform tij.

Ndryshimet e bera me vendim te Asamblese se Partnereve te shoqerise, rregjistrohen ne librin e gjykates qe ka miratuar statutin.

NENI 19

Cdo mosmarveshje qe do te linde ndermjet ortakeve, apo ortakeve dhe administratoreve, do ti ngarkohen per zgjidhje nje Keshilli Arbitrues i perbere nga tre anetare, dy nga te cilet te emruar nga Gjykata e rrethit Tirane.

Arbitrat do te gjykojne perfundimisht dhe ndermjetsit gjyqsor.

NENI 20

Per sa nuk eshte parashikuar nga statuti i tanishem, do te zbatohet legjislacioni ne lenden " pro tempora " ne fuqi.

NENI 21

Ky statut hyn ne fuqi qe nga dita e fillimit te aktivitetit te shoqerise.

NENI 22

Ky statut eshte miratuar me vendim ta Asamblese se Partnereve te shoqerise # EKOBEON # Sh.P.K. me vendim Nr. \_\_\_ dt. \_\_\_/\_\_\_/1995 dhe i dergohet Gjykares kompetente per miratim e rregjistrim.

PARTNERET ORTAKE TE SHOQERISE

\* EKOBEON \* SH. P. K.

PELLUMB KOCIASI

SULEJMAN RUMASI

FATMIR LAMCE

GEZIM JAZXHIU

RAIMOND HAZBALLA

*[Handwritten signatures of the partners]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E DREJTESISE  
NOTERIA  
Nr. 5161

Elbasan, me 26/10/199

V E R T E T I M

Sot me date 26/10/199, ne zyren e noterise perpara meje noteris Majlinda Lato u paraqiten personalisht partneret ortake te Shoqerise " Eurobeton " SH.P.K. Sulejman Rumasi, i biri Bilbilit, Fatmir Lamce, i biri Osmanit, Gezim Jazxhiu i biri Sadikut, Raimond Hazballa, i biri Kadriut, dhe Pellumb Kociasi, i biri Qerimit, qe te peste banues ne Elbasan me kombesi shqiptare dhe me moshe madhore, te afte per te kryer veprime juridike, te njohur prej meje, me ane leter-njoftimit qe me paraqiten, te cilet deklaruan se statuti, eshte hartuar ne perputhje me ligjet ne fuqi dhe me vullnetin e tyre te lire. Neneshkrimi u vertetua nga une noteria.

N O T E R J A

MAJLINDA LATO /



*[Handwritten signature of Majlinda Lato]*

